VENDIM
Nr. 49, datë 8.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Fiona Papajorgji, kryetare;
Marsida Xhaferllari, anëtare;
Sonila Bejtja, anëtare;
Ilir Toska, anëtar;
Genti Ibrahimi, anëtar;
Marjana Semini, anëtare;
Sandër Beci, anëtar,
me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 7.4.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 33 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Altina Nasufi

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Presidenti i Republikës, në mungesë.

Këshilli i Larë Gjyqësor, përfaqësuar nga kryetari Ilir Rusi.

Vojsava Kola, Në Mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 44 (86-2023-775), datë 14.7.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4940, datë 12.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 537, datë 14.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Altina Nasufi për vitin 2021", dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për rimarrjen në shqyrtim të vlerësimit etik dhe profesional të kërkueses për vitin 2021.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Altina Nasufi *(kërkuesja)*, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara, Presidentit të Republikës dhe Vojsava Kolës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimet nr. 535, 536 dhe 537 të datës 17.11.2021, KLGJ-ja ka vendosur hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për tre pozicione të lira, një në fushën e së drejtës administrative (vendimi nr. 535/2021) dhe dy të tjera në fushën e së drejtës civile (vendimet nr. 536/2021 dhe 537/2021). Për këto pozicione ka aplikuar pranë KLGJ-së edhe kërkuesja, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit. Në kuadër të këtyre procedurave, KLGJ-ja ka kryer vlerësimet e kandidatëve dhe me vendimin nr. 537, datë 14.12.2022, "*Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Altina Nasufi për vitin 2021*", e ka vlerësuar kërkuesen në nivelin "shumë mirë", me 382 pikë. Gjykata Administrative e Apelit,

me vendimin nr. 19 (86-2023-362), datë 27.3.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkueses për kundërshtimin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2021 (*vendimi nr. 19/2023*), vendim i cili është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5489 (316), datë 11.7.2024. Më parë, me vendimin nr. 00-2023-1966, datë 22.5.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkueses për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 19/2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka rrëzuar padinë e saj lidhur me vlerësimin etik dhe profesional.

2. Ndërkohë, pas njoftimit të vendimit të mësipërm të Gjykatës Administrative të Apelit, KLGJ-ja ka vijuar procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionet e shpallura dhe, me vendimin nr. 212, datë 28.4.2023, ka miratuar renditjen e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535/2021 të saj, dhe ka propozuar për emërim në atë pozicion kandidaten të renditur të parën, e cila, më pas, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë me dekretin nr. 78, datë 6.6.2023 të Presidentit të Republikës. Ky vendim i KLGJ-së është kundërshtuar në gjykatë nga kërkuesja. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 28, datë 19.5.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë *(vendimi nr. 28/2023)*. Çështja rezulton e regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 31003-00452-00-2025, me status "*në proces*".

3. Me vendimin nr. 315, datë 14.6.2023, KLGJ-ja ka miratuar renditjen e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536/2021 të saj, dhe ka propozuar për emërim në atë pozicion subjektin e interesuar Vojsava Kola, e renditur e para. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë nga kërkuesja, e cila ka pretenduar se për kërkuesen nuk ka ende një vendim përfundimtar për vlerësimin e saj etik dhe profesional, në kushtet kur vendimi nr. 19/2023 i Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e padisë së kërkueses, me të cilën ka kundërshtuar vlerësimin etik e profesional të dhënë me vendimin e KLGJ-së nr. 537, datë 14.12.2022, nuk është një vendim përfundimtar, përderisa ende nuk është gjykuar nga Gjykata e Lartë.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 44 (86-2023-775), datë 14.7.2023 *(vendimi nr. 44/2023)* ka vendosur të rrëzojë padinë e kërkueses. Pasi ka evidentuar se për këto lloj vendimesh, kundërshtimi mund të motivohet vetëm me shkelje në procedurën e ndjekur, ajo gjykatë ka konstatuar se në aktin administrativ të kundërshtuar nuk ka elemente të pavlefshmërisë absolute nga ato që përcaktohen në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative *(KPA)* ose ligje të tjera. Pretendimet për paligjshmëri të aktit, ajo gjykatë i ka gjetur të pambështetura në ligj, duke argumentuar, se: kriteri i parë që dallon dhe rendit kandidatët e kualifikuar për ngritje në detyrë në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë është rezultati i arritur prej tyre në dy "vlerësimet e mëparshme" dhe se në rastin konkret këto vlerësime etike dhe profesionale për të gjithë kandidatët e kualifikuar janë realizuar nga KLGJ-ja përpara fillimit të procedurës për renditjen dhe propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit të renditur i pari; KLGJ-ja nuk ka filluar dhe vijuar me procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar dhe vlerësuar, si edhe me vendimmarrjen për renditjen dhe propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë përpara përfundimit të afatit ligjor të posaçëm të ushtrimit të së drejtës së kundërshtimit në gjykatë të akteve të saj për vlerësimin etik dhe profesional për secilin kandidat të kualifikuar, sikurse edhe përpara sesa Gjykata Administrative e Apelit të dispononte me vendim lidhur me padinë e ngritur nga kërkuesja; vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit është menjëherë i ekzekutueshëm, me shpalljen e tij, pra KLGJ-ja ka detyrimin ligjor të mbajë parasysh disponimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

5. Me dekretin nr. 185, datë 3.8.2023 të Presidentit të Republikës, subjekti i interesuar, Vojsava Kola, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

6. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur rekurs kërkuesja. Pas marrjes dijeni për përbërjen e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që do të shqyrtonte çështjen e saj, ajo ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e tyre. Me vendimin nr. 00-2024-4869, datë 10.12.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk është vërtetuar interes i drejtpërdrejtë i kryesueses në çështjen përkatëse, ndërsa për dy

gjyqtarët e tjerë, ai kolegj ka vlerësuar se kërkuesja nuk ka paraqitur argumente konkrete për përjashtimin e tyre.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkueses kundër vendimit nr. 44/2023 dhe me vendimin nr. 00-2024-4940, datë 12.12.2024 ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar. Gjykata e Lartë ka analizuar pretendimin lidhur me fuqinë ekzekutive të vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit, referuar në nenin 451 të KPC-së, nenin 41 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve)* dhe në jurisprudencën e kësaj Gjykate dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka asnjë dyshim se vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit - si çdo vendim gjyqësor i formës së prerë - përbën një vendim të ekzekutueshëm, duke mos konstatuar asnjë pengesë ligjore për vijimin e veprimtarisë administrative të KLGJ-së në nxjerrjen e akteve objekt gjykimi, për sa kohë që gjykimi mbi vlerësimin etik dhe profesional të kërkueses ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit. Pretendimin për paanshmëri të anëtarëve të trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të pabazuar, pasi ka çmuar se anëtarët e trupit gjykues kanë përmbushur detyrën funksionale duke interpretuar ligjin dhe kanë mbajtur qëndrim për mënyrën e zbatimit të ligjit material, për rrjedhojë nuk mund të ngrihet pretendimi mbi paanshmëri vetëm për shkak të mënyrës si gjykata interpreton ligjin. Sipas asaj gjykate, pretendimeve të kërkueses u është dhënë përgjigje e qartë dhe shteruese nga ana e gjykatës së apelit, ndërsa për pjesën e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, ka evidentuar se del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 29.5.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore që kanë rrëzuar padinë e saj për shfuqizimin e vendimit nr. 315, datë 14.6.2023 të KLGJ-së, me të cilin është miratuar renditja e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536/2021 të saj, si dhe është propozuar për emërim subjektin e interesuar, Vojsava Kola. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 13.6.2025. Pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, në datën 13.6.2025 kërkuesja ka hequr dorë nga pika 3 e objektit të tij, që lidhet me shfuqizimin e vendimit nr. 537, datë 14.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Altina Nasufi për vitin 2021", duke paraqitur një ankim kushtetues individual të ri për këtë pikë. Në lidhje me ankimin e ri, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 282, datë 7.11.2025, ka vendosur moskalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare, pasi i ka gjetur pretendimet e kërkueses haptazi të pabazuara.

9. Për sa i takon këtij ankimi kushtetues individual, Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak në datën 30.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

10. Në datën 26.3.2026 një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se kishte qenë në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 00-2024-4940, datë 12.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 7.4.2026, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Organik të Gjykatës.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesja*,** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar themelin e pretendimeve të kërkueses, por ka disponuar me një vendim mospranimi me vlerësim sipërfaqësor për ekzistencën ose jo të shkaqeve të parashikuara në ligj, pa bërë analizë reale nëse keqzbatimi i ligjit është i një rëndësie të tillë që ndikon sigurinë juridike dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, nëse trajtimi i çështjes ka ndikuar në të drejtën për karrierë ose nëse janë shkelur parime procedurale për shkak të mospezullimit të ekzekutimit të një akti me pasoja të pakthyeshme, çka ka bërë që *rekursi i kërkueses të mos jetë një mjet efektiv*. Gjykata e Lartë nuk ka zhvilluar një analizë për pasojat e pakthyeshme të veprimit të KLGJ-së, pavarësisht pretendimeve të qarta në rekurs se veprimtaria e këtij organi është marrë pa pritur vendimin përfundimtar për vlerësimin e kërkueses, duke sjellë një dëm real dhe të parikuperueshëm në të *drejtën e saj për karrierë*.

11.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, duke paraqitur argumentet e mëposhtme:

11.2.1. Lidhur me formimin e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, dy gjyqtarë të trupës, individualisht ose së bashku, kanë qenë pjesë e trupit gjykues që ka rrëzuar padinë e kërkueses për kundërshtimin e vlerësimit etik dhe profesional, si dhe të trupit gjykues që ka rrëzuar padinë e saj për shfuqizimin e vendimit të KLGJ-së për renditjen e kandidatëve për pozicionin në fushën e së drejtës administrative. Pretendimet në këto procese janë të njëjta, pasi janë të lidhura me efektin e ekzekutimit të vendimit të KLGJ-së për vlerësimin etik dhe profesional të kërkueses. Gjyqtarët janë shprehur për këto pretendime që kanë të bëjnë me përmbajtjen e të njëjtit fakt dhe të njëjtit shkak ligjor, në çështje që u përkasin të njëjtave palë. Interpretimi i ligjit nga ata gjyqtarë nuk është bërë në një kontekst të përgjithshëm, por ka prodhuar efekte konkrete mbi kërkuesen, duke e vendosur në një pozicion më të ulët renditjeje, një rast klasik i konfliktit të interesit. Njëri prej gjyqtarëve ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, çka do të thotë se ai vetë ka vlerësuar me ndërgjegje ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme që nuk e lejojnë atë të marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Refuzimi i kërkesave për dorëheqje është bërë nga gjyqtarja tjetër pjesë e trupës, në atë kohë kryetare në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe vetë palë e interesuar.

11.2.2. Lidhur me formimin e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, kryesuesja ka konkurruar për të tria pozicionet e lira që ka konkurruar edhe kërkuesja (duke u përzgjedhur në pozicionin e së drejtës administrative) dhe ka interes të drejtpërdrejtë në gjykimin e padive të kërkueses lidhur me këto procedura. Dy gjyqtarët e tjerë kanë qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën e saj për pezullimin e efekteve të vendimit nr. 19/2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, si edhe të trupit gjykues që me vendimin nr. 00-2024-5489 (316), datë 11.7.2024, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës administrative të apelit (nr. 19/2023) nëpërmjet të cilit është rrëzuar kërkesëpadia e kërkueses për kundërshtimin e vlerësimit etik dhe profesional, pra janë shprehur negativisht për pretendimet e parashtruara nga kërkuesja. Këto gjykime, në thelb, lidhen me të njëjtin fakt, renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, dhe me të njëjtat subjekte. Pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në të dyja këto çështje cenon besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme. Gjykata e Lartë që ka rrëzuar kërkesën e kërkueses për përjashtimin e anëtarëve të Kolegjit Administrativ (vendimi 4896/2024) është mjaftuar me një analizë formale dhe jo substanciale, duke mos hetuar fare rreth kontekstit të konfliktit të interesit të gjyqtares kryesuese për shkak të kandididimit të saj në të njëjtën procedurë me kërkuesen.

11.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi kërkuesja, në shkelje të hapur dhe flagrante të procedurës ligjore, nuk është njoftuar ose informuar në procesin e renditjes së kandidatëve të kualifikuar për të marrë pjesë në garën për plotësimin e pozicionit të lirë. Gjykata e Lartë duhet të kishte vlerësuar nëse gjatë procesit administrativ kërkueses i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar për pretendimet e saj përpara nxjerrjes nga KLGJ-ja të vendimit të propozimit të renditjes, megjithatë ajo nuk ka analizuar dhe arsyetuar rreth këtyre shkaqeve të ngritura në rekurs, edhe pse të lidhura me cenimin e parimeve të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor.

11.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe fuqisë ekzekutive të vendimeve gjyqësore*, pasi vendimet e kundërshtuara kanë lejuar vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë nga KLGJ-ja pa përfunduar me vendim përfundimtar vlerësimi etik dhe profesional i kërkueses. Në këtë

rast, KLGJ-ja kishte detyrimin që të pezullonte ekzekutimin e vendimit për vlerësimin etik-profesional derisa vendimi të ishte jo vetëm i ekzekutueshëm, por edhe përfundimtar, duke pasur parasysh pasojën, plotësimin e vendit të lirë në Gjykatën e Lartë.

12. ***Subjekti i interesuar, KLGJ-ja***, ka paraqitur prapësime me shkrim si vijon:

12.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkueses në rekurs, duke analizuar konceptin e vendimit të formës së prerë dhe forcën ekzekutive të tij, legjitimitetin e procedurës së ndjekur nga KLGJ-ja në lidhje me vijimin e veprimtarisë në nxjerrjen e aktit të renditjes së kandidatëve në Gjykatën e Lartë, pretendimet për përbërjen e trupit gjykues dhe pretendimet për vendimin e kundërshtuar të KLGJ-së. Pretendimi se nuk janë analizuar pasojat që vendimmarrja e KLGJ-së ka sjellë për kërkuesen nuk qëndron, Gjykata e Lartë ka përmendur faktin se ka përfunduar gjykimi për vlerësimin etik dhe profesional të kërkueses, duke e lënë të pacenueshme renditjen e kandidatëve të bërë nga KLGJ-ja, ndaj rrethanat aktuale në të cilat është marrë vendimi i Gjykatës së Lartë nuk do të sillnin pasoja të ndryshme te kërkuesja.

12.2. *Pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim* nuk qëndrojnë dhe mbeten në nivel hipotetik. Nga ana e kërkueses nuk është paraqitur asnjë provë ose fakt bindës që të mund të vërë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve. Gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjeve me objekt "kundërshtimin e vlerësimit etik-profesional" dhe "kundërshtimin e renditjes së kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë", të cilat kanë objekt dhe shkak ligjor të ndryshëm dhe thjesht fakti se janë të njëjtat palë në proces nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tyre. Fakti i thjeshtë se gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij, ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Për më tepër, mbajtja e qëndrimeve të njëjta për çështje të ngjashme nga trupat gjykues jo vetëm që nuk përbën shkak për paanshmëri, por garanton dhe respektimin e parimit të sigurisë juridike, duke krijuar një praktikë të qëndrueshme gjyqësore. Shqyrtimi i kërkesave për dorëheqje nga gjyqtarja, në cilësinë e zëvendëskryetares të atëhershme në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk përbën konflikt interesi, pasi: i. gjykimet kanë objekt dhe shkak ligjor të ndryshëm; ii. interesi i pretenduar nga kërkuesja nuk ishte më aktual; iii. kryetari është i vetmi autoritet i ngarkuar nga ligji për të shqyrtuar kërkesat për dorëheqje. Anëtarët e Gjykatës së Lartë kanë marrë në shqyrtim çështje me objekte të ndryshme.

12.3. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar* nuk është ngritur në nivel kushtetues, ndaj nuk duhet pranuar. Procedura e ngritjes në detyrë ka qenë transparente dhe kërkueses i janë njoftuar të gjitha aktet dhe fazat e kësaj procedure (fillimi i procedurës dhe caktimi i relatorit, diapozitivi i vendimit të KLGJ-së, njoftimi për vendimin e arsyetuar (paraprak)), për të cilat ajo ka marrë dijeni. Që nga momenti i njoftimit të fillimit të procedurës, kërkuesja ka pasur mundësinë për të paraqitur një kërkesë ose shpjegime lidhur me këtë proces, të drejtë të cilën ajo nuk e ka ushtruar. Vetë KLGJ-ja nuk e ka vlerësuar të nevojshme në asnjë fazë të procedurës të paraqesë shpjegime në lidhje me kriteret e renditjes ose të kërkojë depozitimin e dokumenteve shtesë. Gjithashtu, asnjë akt ligjor ose nënligjor nuk përmban parashikime mbi bazë të të cilave KLGJ-ja të jetë e detyruar të njoftojë kandidatët për ecurinë e kandidatëve të tjerë në procesin e ngritjes në detyrë. E drejta për t'u dëgjuar publikisht nuk është konsideruar nga Gjykata si një e drejtë absolute. Në çdo rast, Gjykata ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, por ndikim në proces kanë ato shkelje, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit.

12.4. *Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe fuqisë ekzekutive të vendimeve gjyqësore* është i pabazuar, për shkak se vendimi i gjykatës së apelit ishte i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm, ndaj KLGJ-ja ka vijuar me procedurat e ngritjes në detyrë, duke pasur parasysh interesin publik për të bërë të mundur funksionalitetin e Gjykatës së Lartë, nevojë që ishte imediate. KLGJ-ja nuk ka qenë në kushtet e pezullimit të parashikuara nga neni 66 i KPA-së, i cili i referohet pezullimit të procedurës derisa të merret një vendim i formës së prerë për çështjen paraprake. Lidhur me pretendimin se KLGJ-ja ka mbajtur

qëndrime të ndryshme në raste të ngjashme, në asnjë rast KLGJ-ja nuk e ka pezulluar procedurën e saj, por në një rast i ka kërkuar Gjykatës së Lartë që ta trajtojë çështjen me prioritet. Kërkueses i janë respektuar të gjitha të drejtat për sa u përket procedurave të ngritjes në detyrë, i janë komunikuar të gjitha aktet procedurale dhe është bërë renditja e kandidatëve në bazë të trajtimit të barabartë dhe objektiv. E gjithë procedura është konfirmuar më tej nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

12.5. *Pretendimin për cenimin e së drejtës për karrierë,* kërkuesja e lidh me faktin se KLGJ-ja duhet të kishte pritur shqyrtimin e rekursit para se të vijonte me ngritjen në detyrë të kandidates tjetër. Për këtë pretendim, ajo nuk ka arritur të argumentojë sesi zbatimi i parashikimeve ligjore për të kandiduar si anëtare e Gjykatës së Lartë përbën cenim të këtij parimi. Vendimmarrja e KLGJ-së e konfirmuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë provon ligjshmërinë e të gjithë procesit në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë nga KLGJ-ja.

13. ***Subjektet e interesuara, Presidenti i Republikës dhe Vojsava Kola***, ndonëse janë njoftuar rregullisht, nuk kanë paraqitur shpjegime me shkrim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

14. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Nga shqyrtimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se kërkuesja i ka shtrirë pretendimet e saj në lidhje me dy kërkime kryesore: i. për vlerësimin etik dhe profesional të saj për vitin 2021 të kryer nga KLGJ-ja, të materializuar me vendimin nr. 537, datë 14.12.2022; ii. për procesin gjyqësor administrativ të përfunduar me vendimin e datës 12.12.2024, të Gjykatës së Lartë, në të cilin kërkuesja ka kundërshtuar miratimin nga KLGJ-ja të renditjes së gjyqtarëve që kandidonin për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile.

16. Në lidhje me kërkimin e parë, sikurse është theksuar në rrethanat e çështjes, kërkuesja, pasi ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, në datën 13.6.2025 ka paraqitur kërkesë me objekt "Për heqje dorë pjesërisht nga objekti i kërkesës", në të cilën ka parashtruar se heq dorë nga pika 3 e objektit të kërkesës së saj: *"Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit të KLGJ-së nr. 537, datë 14.12.2022, "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares Altina Nasufi për vitin 2021", me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit "Shumë mirë" dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në KLGJ për rimarrjen në shqyrtim të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Altina Nasufi për vitin 2021"*, për shkak se do të paraqiste kërkesë të veçantë për të.

17. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit. Neni 31/b i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon të drejtën e kërkuesit për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Ndërsa pika 2 e nenit 43/b të po këtij ligji, që parashikon të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ia njeh këtë të drejtë kërkuesit në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

18. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se kërkuesja pas heqjes dorë nga kërkimi i parë ka paraqitur një ankim të ri kushtetues, për të cilin ka marrë përgjigje me vendimin nr. 282, datë 7.11.2025 të Kolegjit të Gjykatës. Në këto kushte, bazuar në nenin 31/a, pika "dh", të Ligjit Organik të Gjykatës, Gjykata vlerëson se përveçse kërkuesja ka hequr dorë nga ky kërkim, ai është objekt i një vendimi të mëparshëm të Kolegjit të Gjykatës, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa i takon kërkimit të dytë, në drejtim të legjitimimit *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial *(shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Gjykata vëren se kërkuesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor administrativ në përfundim të të cilit është vendosur mospranimi i rekursit të saj, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit që ka rrëzuar padinë e kërkueses, për rrjedhojë, në aspektin procedural të këtij kriteri legjitimimi, kërkuesja rezulton të ketë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Ndërsa për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se çdo individ, person fizik ose juridik, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesja duhet të provojë se është bartëse edhe e së drejtës kushtetuese që pretendohet se i është cenuar nga procesi gjyqësor objekt kërkese.

21. Sikurse u theksua më sipër *(shih paragrafin 14 të vendimit*), kërkimi i dytë i kërkueses ka të bëjë me kundërshtimin gjyqësish të vendimit të KLGJ-së që ka miratuar renditjen e gjyqtarëve që kandidonin për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë në fushën e së drejtës civile *(shpallja nr. 536/2021)* dhe ka propozuar për emërim në atë pozicion subjektin e interesuar, Vojsava Kola. Duke pasur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, Gjykata do të ndalet në verifikimin e së drejtës kushtetuese që vihet në diskutim dhe, më tej, në drejtim të pasojave që i kanë ardhur kërkueses në atë të drejtë, në kuptim të justifikimit prej saj të statusit të viktimës. Gjykata vëren se pretendimet e kërkueses janë fokusuar në aspektet procedurale të procesit të kundërshtuar, duke e lidhur në mënyrë të përciptë atë me të drejtën kushtetuese me natyrë substanciale që kërkon të mbrojë përmes ushtrimit të së drejtës kushtetuese me natyrë procedurale, me të drejtën për punë dhe karrierë.

22. Sipas Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë plotësohen nëpërmjet ngritjes në detyrë (neni 48, pika 1). KLGJ-ja i shqyrton kandidimet dhe i rendit kandidatët që përmbushin kriteret, sipas: i. dy vlerësimeve të mëparshme; ii. në rast se ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, KLGJ-ja i rendit këta kandidatë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; iii. në rast se sërish ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, KLGJ-ja i rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist (neni 48, pika 9). Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, KLGJ-ja propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e këtyre kritereve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve (neni 48, pika 11). Propozimi për emërim është i ankimueshëm (neni 48, pika 11). Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e KLGJ-së në gjykatën kompetente vetëm për shkelje të rënda procedurale (neni 95, pika 7).

23. Në dritën e dispozitave të ligjit të zbatueshëm si më sipër, Gjykata vëren se procesi i renditjes së kandidatëve dhe i propozimit për emërim është i ndërlidhur dhe vjen si pasojë e përmbushjes së një sërë kriteresh, ku kriteri i parë është jo një, por dy vlerësime të mëparshme të magjistratit. Në këtë drejtim, Gjykata ka vendosur të mos marrë në shqyrtim kërkimin e parë të kërkueses, për vlerësimin etik dhe profesional për vitin 2021 nga KLGJ-ja, për shkak të heqjes dorë prej tij, si dhe të vendimmarrjes së mëparshme të Kolegjit të saj. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesja nuk e ka argumentuar cenimin e së drejtës substanciale për shkak

të vendimmarrjes së kundërshtuar, sepse, në vetvete, efektet ligjore të vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesja nuk kanë sjellë dhe as mund të sjellin pasoja të drejtpërdrejta në të drejtën për punë dhe karrierë, për sa kohë që procesi i renditjes së kandidatëve dhe propozimi për emërim janë të ndërlidhur dhe ndërvarur nga procesi i vlerësimit të kandidatëve, kërkim nga i cili kërkuesja ka hequr dorë dhe, që në çdo rast është gjetur i pabazuar nga Kolegji i Gjykatës, ndaj procesi i kundërshtuar duket se nuk ka cenuar ndonjë të drejtë themelore të kërkueses. Për pasojë, Gjykata vlerëson se neni 42 i Kushtetutës nuk merr në mbrojtje procesin gjyqësor për të cilin kërkuesja ka ngritur pretendimet, pra "renditjen", e cila në vetvete nuk lidhet me të drejtën kushtetuese me natyrë substanciale që kërkon të mbrojë kërkuesja.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se, mbështetur në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pabazuar, për rrjedhojë ajo rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 8.4.2026.

Shpallur më 10.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini